



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6382 prot

Gramsh, më 28/09/2018

VENDIM

Nr. 74, datë 24.09.2018

Për

“Miratimin e kërkesës së Bashkisë Gramsh, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimi e ndihmes financiare për familjen e Z.Fiqiri Hoxha, banesa e të cilit është dëmtuar nga rrëshqitja e tokës, nga buxheti i bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2018 ne Ministrin e Mbrojtjes, program “Emergjenc civile”

Në mbështetje të ligjit nr.8756,datë 26.03.2001,“Për emergjencat civile”,neni 2,pika 5,neni 16,17,32,shkronja a,të VKM-së nr.329,datë 16.05.2012,“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”kreu i III-të,të ligjit nr.139/2015,datë 17.12.2015,“Për vet qeverisjen vendore” neni 8 pika 2,neni 9 pika 1/1b.

VENDOSI:

1. Të miratoj kërkesën e Bashkisë Gramsh për mbështetje financiare shtetasit Fiqiri hoxha për dëmtimin e banesës së tij nga rrëshqitja e tokës.
2. Të miratoj dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Gramsh.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit Fiqiri Hoxha, ndihmën emergjente ne vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondin e emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2018
4. Të paraqesë dokumentin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkakë të pamundesisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.

5. Ndhimja financiare për familjen e shtetasit Fiqiri Hoxha, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
6. Ndhimja financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Fiqiri Hoxha, banesa e të cilit është dëmtuar nga rrë shqitja e tokës.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë
Astrit DUZHA



Konc.A.Duzha
Daktil A.Duzha
Dosja nr. _____
Afati _____



Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Shkëlqim HOXHA

